



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE" VLORE**

---

**VENDIM**

**Nr 2, Dt. 29.09.2009**

***Per marrje leje, per perdorim uji, prej burimeve ujore te lumit Carshove (Dege e lumit Vjose), per prodhim te energjise elektrike nepermjet HEC -it "Radove", shoqerise "Tulla - T" Shpk - Albania***

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "Tulla-T" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave, qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per "Koncesionet", vendimit te K.M nr.27, dt. 19.01.200, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve" vendimit nr.3, dt. 19.07.2002 te K.K.U-se, "Per miratimin e rregullores te sekretariatit Teknik" te K.K.U-it, te K.B.U -se, si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, Vendimit te KM nr.619, dt. 19.09.2007 "Per percaktimin e autoritetin kontraktues, per dhenien me koncesion te HEC-it "Radove", dhe miratimin e bonusit, per proceduren perzgjedhese konkurese qe i jepet shoqerise, si dhe kontrates koncensionare, te formes "BOT", per ndertimin e hidrocentralit "Radove" nr. 680, dt. 03/03/2009 lidhur ndermjet M.E.T.E dhe shoqerise "Tulla - T" sh.p.k. Duke marre ne konsiderate dokumentacionin e mesiperm dhe kerkesen e subjektit, si dhe vendimin nr. 33 dt. 06/08/2007 te K.B.U "Vjose", "Per miratim te kerkeses per dhenie me koncesion te burimit ujqor te lumit te Carshoves per prodhim te Energjise Elektrike, nepermjet HEC-it "Radove", si dhe relacionin e paraqitur nga A.U.B "Vjose". K.B.U"Vjose"

**VENDOSI:**

1- Miratimin e kerkeses te bere nga shoqeria " Tulla - T" sh.p.k, per dhenie leje, "Per perdorim te burimit ujqor" te lumit Carshove (dege e lumit Vjose) per prodhim te energjise elektrike, Nepermjet HEC -it "Radove".

2- Veprat e marrjes, do te jene ne vendin me kordinata :

X = 44 63 342

Y = 44 47 886.7

Z = 606m.

3- Sasia e ujqit qe jepet per perdorim per prodhim te energjise elektrike do te jete mesataarisht 1 m<sup>3</sup>/sek.

**Vazhdim i Vendimit Nr. 2, Dt. 29.09.2009**

4- Periudha e perdorimit do te jete gjate gjithë vitit, periudhes 1 qershor deri me 30 shtator do ti zbritet 0.1 m<sup>3</sup>/sek uje, qe do te perdoret per ujitjen e kulturave bujqesore.

5 - Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.

6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere .

**PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"**  
**Vezi METAJ**



**KRYETARI I K.B.U "VJOSE"**  
**Hasan HALILI**

